

TË HUMBASËSH SHPRESËN PËR JETËN

Kur Thomas Paine ishte në prag të vdekjes, disa nga shokët e tij jobesimtarë erdhën për ta parë dhe me një ton të ashpër dhe të pamëshirshëm i thanë: «Thomas Paine! Kemi dëgjuar se dëshiron të bëhesh kristian, por ne shpresojmë se ti do të vdesësh ashtu siç ke jetuar». Pastaj ata u larguan. Duke iu drejtuar zonjës që po e ndihmonte, Paine tha: «E shikon se sa ngushëllues “të mirë” janë shokët e mi?» Njëherë ai e pyeti zonjën që i shërbente nëse kishte lexuar ndonjë nga shkrimet e tij. Ajo i tha se sapo kishte filluar të lexonte librin «*Koha e arsyes*», por libri e kishte mërzhitur atë kaq shumë sa që ajo e kishte hedhur atë libër në zjarr. «Unë do të doja që të gjithë lexuesit e atij libri të kishin vepruar si ti», tha ai, «sepse nëse Djalli ka pasur ndonjëherë ndonjë influencë në punën time, kjo ka qenë kur unë shkrova atë libër». Kur ajo dilte nga dhoma ku Thomas Paine dergjej në shtratin e tij për të marrë ujë apo ndonjë gjë tjetër, shpesh shërbyesja do ta dëgjonte atë të përsëriste fjalët: «Zot! Zot!» apo: «Zot Jezus, ki mëshirë për mua!» Thuhet se ai shkroi shumë gjëra gjatë sëmundjes së tij. Meqenëse asnjë nga këto shkrime nuk është gjendur, merret me mend se shokët e tij jobesimtarë i zhdukën ato, meqenëse ato nuk përfaqësonin më pikëpamjet e tij të mëparshme.

Në këtë mesim ne do të përqëndrohemi rreth një fakti të rëndësishëm, rreth vdekjes së trupave tanë. Në mënyrë të veçantë, ata që kanë më shumë frikë nga vdekja janë jobesimtarët. *Hamleti* i Shekspirit e ilustron mirë këtë dilemë. Kur po pyeste «Të jesh

apo të mos jesh?» Hamleti po mendonte për vdekjen: «Në atë gjumë të vdekjes çfarë ëndrrash mund të vijnë...për të na qetësuar.» Në realitet, kjo është e vërtetë, sepse, nëse ndërgjegjja (ëndrrat) ekziston pas vdekjes, atëherë ne duhet t'i japim një përgjigje çështjes serioze të pavdekësisë. Një arsye tjetër për të shqyrtuar mundësinë e pavdekësisë është besimi ateist se vdekja është fundi i çdo gjëje për njeriun!

Vdekja është ironike. Njerëzit mendojnë shpesh për të, por në anën tjetër ata diskutojnë fare pak për të. Ajo është quajtur «armiku i fundit», «fuqia e panjohur», ose paraqitet si një vjedhës që i rrëmben njeriut fuqitë dhe mundësitë. Teknologjia moderne ka zgjeruar mundësitë e njeriut për dije dhe njohuri. Njeriu mund të përshkruajë fillimin e jetës nga zigota (qeliza fillestare e formuar nga dy qeliza të tjera) deri te lindja e foshnjës. Ne mund ta ndjekim jetën e njeriut nga fazat a para të zhvillimit në barkun e nënës deri sa ai arrin në moshë të vjetër. Sidoqoftë, madje dhe në ditët e sotme, ne nuk kemi aspak më shumë njohuri për momentin pas vdekjes se sa njerëzimi kishte shekuj më parë! Të gjithë ata që mohojnë Biblën nuk kanë njohuri për botën përtej varrit. Injoranca prodhon frikë. Ravi Zacharia ka shkruar se me «ardhjen e vdekjes ateizmi “takon” ndëshkimin e tij. Çdo teori apo filozofi që nuk është e aftë të shpjegojë origjinën e njeriut dhe arsyen e ekzistencës së tij, natyrisht duhet të heshtë, kur vjen fjala për fatin e njeriut pas vdekjes. Por në qoftë se ata zgjedhin që të debatojnë, e vetmja gjë që u

mbetet për të thënë është asgjëja.» Aspekti më i frikshëm i vdekjes, për njerëzit që nuk janë besimtarë, është se në një moment të vetëm, kur të vdesin, do të lënë mbrapa çdo gjë që kanë, ndërsa vetë humbasin dhe nuk janë më! Gjithë pasuria e grumbulluar me shumë djersë, gjithë sukseset që me shumë mund i kemi arritur dhe gjithë nderimet që i kemi merituar në jetë nuk kanë më asnjë vlerë kur vjen vdekja!

Vdekja tregon qartësisht gabimet e ateizmit. Ateizmi nuk ofron ndonjë ngushëllim për vdekjen. Bertrand Russell u shpreh në këtë mënyrë:

Gjithë punët që janë bërë në histori, gjithë dedikimi, gjithë frymëzimi, gjithë shkëlqimi i mrekullueshëm i zgjuarësisë njerëzore, janë të destinuara të zhduken...dhe gjithë tempulli i arritjeve njerëzore në mënyrë të pashmangshme duhet të varroset nën mbeturinat e një universi të rrënuar.

Pas këtij përshkrimi pesimist, Russell arriti në përfundimin se njerëzit ballafaqohen në jetë vetëm me «themelet e forta të dëshpërimit të pashpresë».

Cili njeri, që arsyeton në mënyrë të drejtë, do të dojë një jetë të tillë? Kjo është pasoja e ateizmit. Një pikëpamje e tillë na paraqet një përshkrim shumë të deformuar për njeriun. Kjo pikëpamje është përshkruar me humor nga Ravi Zacharias:

Në fund të fundit, pikëpamja ateiste bën që botanisti, nga studiuues i luleve, të kthehet në pleh për to, shkencëtari, nga argumentuesi i «big bang»-ut (teori për formimin e universit), kthehet në një flluckë të vogël të parëndësishme të këtij procesi dhe gjeologu, nga studjuues i një formacioni gjeologjik, kthehet në një nga shtresat e këtij formacioni.

Nuk ka dënim më të madh se sa përshkrimi pesimist që ofron ateizmi për jetën dhe të ardhmen e njerëzimit. Shikoni ndryshimin e madh midis jetës së pashpresë të ofruar nga ateizmi dhe jetës me shpresë ofruar nga besimi te Perëndia.

PËRGJIGJET QË JEP ATEIZMI

Ateizmi nuk mund të japë ndonjë përgjigje për fundin e jetës. Asgjë nuk kërcënon ëndrrat, shpresat, dëshirat dhe arritjet e jetës më shumë se sa vdekja e një të afërmi. Shumë njerëz hidhërohen kaq shumë nga vdekja e të afërmeve të tyre sa sëmuren vetë për vdekje. Pse është humbja e një njeriu të afërm kaq shkatërruese për njerëzit? Sepse njerëzit u krijuan që të ndihmohen dhe të inkurajohen nga këto marrëdhënie të veçanta me njëri-tjetrin. Pa këto

marrëdhënie të veçanta ekzistenca njerëzore do të ishte e pasuksesshme dhe e pavlerë. Zanafilla 2:18 e provon këtë fakt. Pavarësisht nga luksi i kopshtit të Edenit, diçka nuk shkonte në jetën e njeriut të parë. Njeriu i mungonte ajo lloj lidhje e ngushtë që gjendej vetëm në marrëdhëniet e veçanta njeri-njeri. Për ateistin vdekja bën që kjo marrëdhënie të zhduket përfundimisht, kur një i afërm vdes! Ateizmi nuk mund të shpjegojë boshllëkun që shkakton vdekja. Ai nuk është në gjendje të ofrojë shpresë për pasojat e vdekjes. Njeriu ka dëshirë të pa masë që të takojë përsëri njerëzit e tij të afërm që kanë vdekur në të kaluarën. Ateizmi nuk ofron asnjë shpresë për të përmbushur këtë dëshirë të njeriut. Ateizmi nuk i përgjigjet pyetjes «Ku është i afërmi im?»

Ateizmi nuk i përgjigjet dot pyetjes se si do të ushtrohet drejtësia mbi të keqen dhe mbi të mirën. Madje, ateisti dëshiron drejtësi edhe pse filozofia e tij e mohon atë, por ai prapë rend pas saj! Por prapë, ateizmi nuk jep përgjigje se si drejtësia do të vendoset kur njeriu i keq të ketë vdekur. Disa teori ateiste janë përpjekur që ta zgjidhin këtë problem duke përdorur teorinë e mishërimit, por kjo është e pamjaftueshme. Ateizmi nuk jep ndonjë përgjigje për mbretërimin e të keqes! Ai nuk jep ndonjë përgjigje rreth pavlefshmërisë së punës tokësore. Kjo situatë përshkruhet te Luka 12:20, kur Perëndia e pyet të riun pasanik se çfarë përfitimi do të ketë ai nga gjithë puna e tij kur ai të vdesë. Sipas ateizmit, gjithë përpjekjet e njeriut në fund të fundit zhvlerësohen nga vdekja! Ateizmi mbron idenë se e gjithë puna në shërbim të të tjerëve është absurde. Interesi i ateistit është gjithmonë i përqëndruar te vetvetja. Ateisti që mbështet projektet humanitare është një hipokrit! Ateizmi nuk u përgjigjet atyre që pyesin: «Pse duhet të punoj, të sakrifikoj qejfet e mia dhe të ndihmoj zhvillimin e njerëzimit?»

Ateizmi nuk i përgjigjet «ndjenjës» së përjetësisë që gjendet brenda zemrës së çdo njeriu. Të gjithë e pranojmë, nëse tregojmë të vërtetën, se kemi një ndjenjë të përjetësisë brenda nesh. Ne «e dimë» se «diçka» ekziston përtej jetës njerëzore. Indianët i përgatisnin të vdekurit sikur do të shkonin për gjah. Një komb tjetër i dërgonte të vdekurit për të lundruar drejt Valhalas, për të mbretëruar midis heronjve të së kaluarës. Edhe pse këta njerëz nuk kishin njohuri për Perëndinë, ata prapë pranonin atë që ateistët dhe «intelektualët» e sotëm nuk duan ta pranojnë! Mbreti Solomon tha se Perëndia «ka vënë madje përjetësinë

në zemrat e tyre» (Predikuesit 3:11). Pavarësisht se sa i pasur bëhet një njeri, ai prapë ndihet bosh përbrenda derisa ai të njohë Perëndinë! Ateizmi nuk mund ta shpjegojë dot këtë «ndjenjë» të përjetësisë.

Ateizmi nuk mund të shpjegojë se si shpresa është vrarë prej mënyrës sipas së cilës ai shpjegon botën. Pasi kanë «vlarë Perëndinë», ateistëve nuk u ka mbetur ndonjë mënyrë që të shpjegojnë ekzistencën e njeriut, moralin që duhet ta drejtojnë atë në jetë, kuptimin e jetës apo për shpresën që njeriu ka në jetë apo pas saj! Humbja fatale e shpresës shkatërron gjithë mundësinë për të patur gëzim në të tashmen. Shpresa është një faktor thelbësor për të kuptuar jetën. Percy Bysshe Shelley, një nga shkrimtarët më të dëgjuar amerikanë të shek. XX, reflektoi për situatën pa përgjigje të *filozofisë ateiste* kur hodhi në letër «*Vargje të shkruara në trishtim, dhjetor 1818, afër Napolit*»:

Unë, nuk kam shpresë për shëndetin
As paqe të brendshme dhe as qetësi përreth,
As edhe atë lumturi që ia kalon pasurisë
Mençuria në meditim u gjend,
Dhe eci me lavdinë e brendshme të kurorëzuar;
As famë as pushtet as dashuri as qetësi,
Të rrethuar prej këtyre gjërave unë shikoj njerëzit e
tjerë,
Me buzëqeshje ata jetojnë dhe qejf ia venë emrin
jetës së tyre:
Për mua nuk është më ashtu.

Të gjithë ata që kanë të njëjtën pikëpamje ateiste me Shelley-n ballafaqohen me këtë situatë të pashpresë e shkatërrimtare.

Humbja e shpresës ka pasoja tragjike te njeriu. Çdo përpjekje mbijeton për arsye të shpresës. Pa shpresë gjithçka bëhet e pavlerë dhe e pakëndshme. Pa shpresë, dëshpërimi shtyp dhe mposht të ardhmen tonë. Është mungesa e kësaj shprese që e ka shtyrë shoqërinë e sotme të përfshihet kaq shumë në imoralitetin seksual, në abuzimin e drogës, në rritjen e terrorizmit dhe të krimin të rrugës. Njerëzit kërkojnë qëllimin dhe kuptimin për jetën, por një shoqëri që udhëhiqet nga idetë ateiste është e pa shpresë.

Çdo njeri përpiqet që në forma të ndryshme të gjejë shpresën dhe kuptimin për jetën e tij. Rinia i ilustron më së miri përpjekjet për të gjetur shpresë. Moshat e reja, në përpjekje për të gjetur shpresën, besojnë në astrologji, në magji, në seks dhe në çdo gjë tjetër që i duket premtuese për t'i dhënë kuptim jetës së tyre. Këta njerëz jetojnë në një shoqëri që

mohon Perëndinë dhe me çdo mënyrë kërkojnë diçka që t'i japë kuptim ekzistencës së tyre! Ateizmi e ka braktisur shpresën për të ardhmen. Ateizmi nuk mund të ofrojë ndonjë të ardhme inkurajuese. Ai vetëm iu ofron njerëzve një botë pa shpresë, një botë të pakuptimtë të zhytur në «dëshpërim të paparë», një varr nën rrënojat e universit. Kush është ai njeri i «arsyeshëm» që dëshiron të ndjekë këtë drejtim për jetën e tij?

PËRGJIGJET E PERËNDISË

Por ndryshe nga zbrazëtia që ofron ateizmi, Perëndia ofron zgjidhje të plota dhe të kënaqshme! Shikoj me kujdes këto zgjidhje që ofrojnë një jetë plot me shpresë.

Perëndia thotë se, edhe pse vdekja ndan njerëzit nga njëri-tjetri, kjo është vetëm një ndarje e përkohshme! Në një film, dy vëllezër u plagosën në të njëjtën kohë. Një mik i gjeti ata krah për krah duke folur për shtëpinë e tyre, për nënën e tyre dhe për dashurinë e tyre për Perëndinë dhe për vendin e tyre. Ata u lutën për njëri-tjetrin, për miqtë e rënë në luftë dhe në mënyrë të veçantë për nënën e tyre. Nuk kaloi shumë kohë dhe vëllai më i ri vdiq. Vëllai i madh, i qorrur nga një plumb, nuk e mori vesh se vëllai më i vogël vdiq dhe vazhdoi t'i fliste atij me fjalë inkurajuese. Por meqë nuk dëgjoji ndonjë përgjigje, ai tha: «Të voglin Rob e ka zënë gjumi» pa e ditur se Robi ishte duke bërë gjumin e tij të fundit. Pas disa minutash edhe vëllai i madh vdiq. Kështu të dy ata ishin prapë së bashku në vendin ku zhurmat e betejës nuk mund t'i shqetësonin më.

Për kristianin ekziston shpresa për ribashkim pas vdekjes! Davidi foli për këtë shpresë me rastin e vdekjes së fëmijës së tij (2 Samuelit 12:23). Krishti foli për një ribashkim gjatë festës së madhe në qiell (Mateu 8:11). Në Bibël gjenden pjesë të tjera që ofrojnë shpresë për ata që vuajnë nga ndarja që sjell vdekja e ndonjë të afërmi (Luka 20:34–36; Mateu 25:34; Kolosianëve 1:12; 1 Thesalonikasve 4:17; Hebrenjve 12:23; Zbulesa 5:9).

Perëndia thotë se drejtësia do të zbatohet si mbi ata që kanë bërë mirë edhe mbi ata që kanë bërë keq. Përgjigjja është e thjeshtë: «Perëndia do të gjykojë si të drejtin ashtu edhe të ligun» (Predikuesit 3:17, 11:9, 12:13–14; Danieli 7:9–10, 12:2; Romakëve 2:5–9; 1 Korintasve 3:8).

Perëndia thotë se gjithë përpjekjet njerëzore kanë vlerë për këtë jetë dhe për atë që do të vijë.

Kristiani ka shpresë, sepse e di se të gjitha përpjekjet e tij kanë vlerë!

Dy ushtarë po diskutonin vdekjen e një shoku. Diskutimi vijoi si më poshtë:

- «Më në fund ai e mbaroi karrierën e tij.»
- «Jo, ky nuk është mbarimi i karrierës për të.»
- «Në qoftë se ky nuk quhet mbarimi i karrierës, atëherë çfarë mund të quhet?»
- «Është vetëm transferim.»
- «Ku u transferua?»
- «Në departamentin tjetër.»
- «Për çfarë?»
- «Ka një detyrë për të përmbushur atje.»
- «Çfarë detyrë?»
- «Atë nuk e di unë, varet se çfarë meriton.»

Kristianët «meritojnë» shpërblimin «për punët që ata kryejnë gjatë jetës së tyre në tokë» (Zbulesa 14:13; Predikuesit 3:12–13, 9:10; Mateu 10:42, 25:35–36; Kolosianëve 1:10; Hebrenjve 6:10; Zbulesa 22:14).

Perëndia thotë se «ndjenja» e të përjetshmes ekziston për arsye të ekzistencës së shpirtit të përjetshëm brenda çdo qenieje njerëzore! Pyetja: «Çfarë të mire duhet të bëj që të kem jetën e përjetshme?» (Mateu 19:16) është në mendjen e secilit (Predikuesit 12:6–7; 2 Korintasve 5:1). Vetëm Perëndia mund t'i përgjigjet kësaj pyetjeje.

Perëndia thotë se «shpresa» ekziston dhe i inkurajon të gjithë njerëzit që t'i binden vullnetit të Tij (Romakëve 8:24–25). «Jeta me bollëk» është një premtim si për jetën në tokë ashtu edhe për jetën që vjen pas vdekjes (Gjoni 10:10).

KONKLuzioni

Vdekja është një faktor shumë i rëndësishëm që përcakton ekzistencën apo mungesën e «shpresës» në jetën tonë. Pasojat e ateizmit janë shumë tragjike. Ateizmi nuk sugjeron ndonjë shkak për fillimin e botës, nuk ofron ndonjë ligj për të drejtuar moralin, nuk u jep kuptim përpjekjeve për një jetë më të mirë dhe nuk jep shpresë që të ndriçojë të ardhmen. Ky përshkrim i pashpresë është dhënë në mënyrë shumë të gjallë tek Efesianëve 2:11–12. Ja si i përshkruajnë këto vargje ata që s'besojnë në Perëndi:

Prandaj kujtohuni se dikur ju johebrenj në mish, të quajtur të parrethprerë nga ata që e quajnë veten të rrethprerë, sepse të tillë u bënë në mish, nga dora e njeriut, ishit në atë kohë pa Krishtin, të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë.

Besimi te Perëndia na ofron fitore të plotë për jetën e tanishme dhe për atë që do të vijë! Sot në botë ai që është fitimtari mund të jetë nesër i munduri. Pompei u përmbys nga Çezari, i cili më pas ra në duart e armiqve të tij. Napoloni pushtoi gati gjithë Evropën dhe më pas vendi i tij u pushtua nga të tjerët. Por fitorja e kristianëve mbi vdekjen është absolute. Rezultati është përfundimtar. Kristiani ka mundur armikun e tij të fundit dhe nuk ka më beteja për të luftuar! Le të bashkohen të gjithë besimtarët me Moisiun, në ftesën që ai i bën shoqërisë sonë për të zgjedhur Perëndinë dhe, në këtë mënyrë, të zgjedhim jetën (Ligji i Përtërirë 30:19–20).

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*
Marrë nga studimi: “*Perëndia kundër ateizmit*”
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara